



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 311/10 prot.

Tiranë, më 18.3.2021

**NJOFTIM
SHPALLJE PUBLIKE VENDIMI (JR) NR. 42, DATË 28.12.2020**

Subjekti i rivlerësimit: Astrit Haxhialushi

Adresa: **Rruga “Mustafa Matohiti”, pallati Selitës, ap. 23, Njësia Administrative nr. 5, Tiranë.**

Në zbatim të nenit 133, gërma “b” të K.Pr.Civile, bëhet “Njoftim me shpallje publike” i vendimit (JR) nr. 42, datë 28.12.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, që i përket subjektit të rivlerësimit Astrit Haxhialushi.

Ky njoftim së bashku me vendimin do të qëndrojë i afishuar për jo më pak se 20 ditë, në këndin e Njoftimeve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe do të botohet në rubrikën “Shpallje” në faqen zyrtare të Kolegjit të Posaçëm të Apelit¹.

Shpallja është afishuar sot më datë 18 / 03 / 2021

(Emër, Mbiemër)

(Nënshkrimi)

(*Adelajda Hister Hysaj*)



¹ <http://kpa.al/shpallje>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 7/2020 (JR)
Datë 05.02.2020

Vendim nr. 42 (JR)
Datë 28.12.2020

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Ina Rama	Relatore
Natasha Mulaj	Anëtare
Ardian Hajdari	Anëtar
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 28.12.2020, ditën e hënë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Gerrit Sprenger, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejdini, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Astrit Haxhialushi, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 225, datë 07.01.2020.

BAZA LIGJORE: Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, neni 6 e në vijim; Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, e ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenet 63, 4/6, 47, 3/16, 58/1, 66/1/c e vijim; ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi u vu në dijeni për vendimet nr. 7/7, datë 17.12.2020 dhe nr. 7/8 datë 17.12.2020 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), të cilët kanë deklaruar të papranueshme kërkesën e subjektit të rivlerësimit për përjashtimin nga trupi gjykues i gjyqtareve Ina Rama e Natasha Mulaj, shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore publike, të zhvilluar në mungesë të ankuesit, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr.

Faqja 1 nga 9



84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, i cili ka kërkuar përfundimisht ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr. 225, datë 07.01.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lidhur me pikën e dytë të dispozitivit të këtij vendimi, i cili përcakton humbjen e së drejtës së këtij subjekti për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, duke kërkuar mosaplikimin e këtij kufizimi, dëgjoi gjyqtaren relatores Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Astrit Haxhialushi, në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179/b të ndryshimeve kushtetuese, të miratuara me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, ishte gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe, për rrjedhojë, në zbatim të kësaj dispozite, dhe parashikimit të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar prej Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, duke u shortuar si subjekt rivlerësimi me shortin e hedhur më datë 17.09.2019.
2. Komisioni, për subjektin e rivlerësimit Astrit Haxhialushi, ka filluar hetimin administrativ për të tria kriteret e vlerësimit, përkatësisht kontrollin e pasurisë, figurës dhe të aftësisë profesionale. Nga aktet e administruara në fashikull, rezulton se Komisioni, më datë 14.01.2020, ka filluar komunikimin me subjektin e rivlerësimit duke e njoftuar atë për përbërjen e trupës gjyqësore dhe më datë 20.01.2020 i ka përcjellë subjektit pyetësin standard nr. 1, për të cilin ai ka dërguar përgjigjet e shpjegimet e tij në datën 30.05.2019. Ky ndërveprim midis Komisionit e subjektit të rivlerësimit rezulton se ka vijuar me komunikimet lidhur me pyetësin nr. 2, për të cilin subjekti ka kthyer përgjigje në datën 05.07.2019 dhe me pyetësin nr. 3, për të cilin subjekti ka kthyer përgjigje në datën 22.09.2019.
3. Më datë 10.10.2019, subjekti i rivlerësimit Astrit Haxhialushi i është drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), me kërkesën me objekt: “Mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para KLGj-së”, nëpërmjet së cilës ka paraqitur dorëheqjen nga detyra e gjyqtarit, bazuar në nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Kjo kërkesë prej vetë subjektit i është drejtuar për dijeni edhe Komisionit të Pavarur të Kualifikimit¹.
Bazuar në kërkesën për dorëheqje të subjektit të rivlerësimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 269, datë 04.12.2019, ka vendosur të pranojë kërkesën e tij dhe të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për z. Astrit Haxhialushi, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

¹ Protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me nr. {***} prot., datë 10.10.2019.



4. Komisioni, më datë 05.12.2019, ka administruar shkresën² e KLGj-së, nr. {***} prot., datë 4.12.2019, me anë të së cilës përcillej vendimi “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Tiranë, z. Astrit Haxhialushi”. Nga kjo shkresë rezulton se KLGj, bazuar në nenin 61 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar dhe në nenet 64 dhe 65 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit të rivlerësimit, me vendimin nr. 269, datë 04.12.2019 – *vendosi të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për z. Astrit Haxhialushi, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për shkak të dorëheqjes së tij nga ky status*. Në këtë vendim, është deklaruar gjithashtu se subjekti ka të drejtën e ankimit të këtij vendimi brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit


5. Komisioni, pas marrjes dijeni të vendimit të KLGj-së për mbarimin e statusit të subjektit të rivlerësimit, ka verifikuar nëse ndaj këtij vendimi subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila ka konfirmuar³ se subjekti nuk ka paraqitur ankim pranë saj brenda afatit ligjor.
6. Pas konfirmimit të Gjykatës Administrative të Apelit për mosankimin e vendimit të KLGj-së, Komisioni, me vendimin nr. 225, datë 07.01.2020 – bazuar në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 269, datë 04.12.2019, i cili ka vendosur të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për z. Astrit Haxhialushi, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për shkak të dorëheqjes së tij nga ky status (për arsye shëndetësore) dhe bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës – ka vendosur të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Astrit Haxhialushi dhe humbjen e së drejtës së tij për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

III. Shkaqet e ankimit

7. Subjekti i rivlerësimit Astrit Haxhialushi ka ushtruar ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 225, datë 07.01.2020, duke pretenduar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon.
- 7.1 Sanksioni i vendosur në pikën 2 të vendimit të Komisionit, e cila deklaron humbjen e së drejtës së këtij subjekti për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, është marrë:
- në shkelje të ligjit procedural të nevojshëm për t’u aplikuar në të tilla raste dhe në kundërshtim me jurisprudencën e GjEDNj-së;
 - në zbatim të gabuar të ligjit material.

² Shkresa e KLGj-së nr. {***} prot., datë 4.12.2019, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me nr. {***} prot., datë 05.12.2019.

³ Me shkresën nr. {***}, datë 23.12.2019, të protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me nr. {***} prot., datë 23.12.2019.



IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin Astrit Haxhialushi dhe për të cilin subjekti i rivlerësimit nëpërmjet ankimit kërkon ndryshimin e tij, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

9. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

10. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar (në vijim "ligji nr. 49/2012") për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për çështjen objekt gjykimi, Kolegji, pasi shqyrtoi në dhomë këshillimi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me procesin e rregullt ligjor, me vendim të ndërmjetëm, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin 51, pika 1, shkronja "b" e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, vendosi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, për t'i dhënë mundësinë subjektit të rivlerësimit të dëgjohej lidhur me çështjen e tij.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit

11. Subjekti, duke qenë dakord me ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, ka pretenduar në ankim se sanksioni i vendosur në pikën 2 të vendimit të Komisionit, i cili deklaroi humbjen e së drejtës së këtij subjekti për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, është marrë në shkelje të ligjit procedural të nevojshëm për t'u aplikuar në të tilla raste, pasi: (i) prej Komisionit nuk janë zbatuar përcaktimet e nenit 179/b, pika 2 e Kushtetutës, e cila kërkon që procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve të kryhet mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt ligjor, dhe se (ii) procesi në Komision nuk ka

zbatuar procedurat e Kodit të Procedurave Administrative ose ligjin nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të cilat në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, janë cilësuar se duhen zbatuar përgjatë rivlerësimit. Subjekti ka pretenduar në ankim se, përveç shkeljeve të dispozitave të mësipërme, procesi administrativ në Komision është zhvilluar gjithashtu edhe në mosrespektim të jurisprudencës së Gjykatës së të Drejtave të Njeriut⁴.

11.1 Kolegji mori në shqyrtim këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit duke analizuar situatën faktike, referuar akteve të ndodhura në fashikullin e formularit në Komision për këtë proces. Siç është përshkruar edhe në pjesën hyrëse të këtij vendimi, në të cilin janë pasqyruar veprimet procedurale që ka zhvilluar Komisioni përgjatë procesit të rivlerësimit për subjektin, ashtu edhe komunikimet që ka pasur me të, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka dhënë dorëheqjen nga detyra, pasi Komisioni kishte kryer aktivitetet procedural dhe kishte avancuar në proces nëpërmjet pyetjeve drejtuar subjektit për çështje të konsideruara të nevojshme për kryerjen e procesit të rivlerësimit. Subjekti rezulton të ketë qenë aktiv në këtë proces nëpërmjet kthimit të përgjigjeve në datat e përshkruara më lart⁵. Pas këtij komunikimi, rezulton se Komisioni ka administruar kërkesën e subjektit për dorëheqje të paraqitur para KLGj-së⁶, si edhe vendimin e këtij organi me nr. 269, datë 04.12.2019⁷, me anë të cilit është deklaruar mbarimi i statusit të magjistratit për subjektin e rivlerësimit Astrit Haxhialushi. Nga aktet e administruara në fashikullin e të analizuar nga Kolegji, nuk rezulton që mes subjektit të rivlerësimit e Komisionit të ketë pasur një komunikim tjetër pas kryerjes së këtyre veprimeve procedurale, të cilat kanë konkluduar prej Komisionit me vendimmarrjen objekt shqyrtimi.

11.2 Në përgjigje të pretendimeve të subjektit e që adresohen drejt shkeljes së parimeve të një procesi të rregullt të kryer ndaj tij në Komision, Kolegji konstatoi se evidentoheshin shkelje të këtyre rregullave që kishin prodhuar si pasojë zhvillimin e një procesi të parregullt ndaj subjektit të rivlerësimit për sa u përket procedurave të nevojshme për t'u zhvilluar prej Komisionit në drejtim të verifikimit të vullnetit të subjektit për t'u dorëhequr nga detyra nëpërmjet dëgjimit të tij në një seancë dëgjimore për këtë qëllim.

11.3 Kolegji nënvizon se ky proces lidhet vetëm me procedurën e ndjekur për marrjen e vendimit të ndërprerjes së procesit të rivlerësimit e zbatimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës dhe jo me veprimtarinë procedurale të zhvilluar nga Komisioni në funksion të kryerjes së procesit të rivlerësimit që i paraprin momentit të dorëheqjes prej subjektit të rivlerësimit. Kolegji çmon se ky aktivitet nuk mund të jetë objekt vlerësimi e shqyrtimi prej Kolegjit, për sa kohë që vendimmarrja e Komisionit nuk ka dalë në zbatim e konkluzion të përfundimeve të dala nga kjo veprimtari hetimore, por është ndërprerë së vazhduari për shkak të dorëheqjes së subjektit nga detyra, fakt që ka shkaktuar si konsekuencë, mbarimin e statusit të tij si magjistrat.

11.4 Kolegji konstaton se Komisioni, pas administrimit të vendimit të KLGj-së që deklaroi mbarimin e statusit të subjektit, nuk ka pasur komunikime të mëtejshme me

⁴ Për këtë pretendim, subjekti referon në ankim vendimet e GjEDNj-së të çështjeve:

Case of Paliutis kundër Lituanisë, datë 24.11.2015; Van de Hurk kundër Holandës, datë 11.04.1994; Ramos Nunes de Carvalho e Sa kundër Portugalisë, datë 06.11.2018; Kudeshkina kundër Rusisë, datë 26.02.2009; Regner kundër Republikës Çeke, 19.06.2017; Colloredo Mannsfeld kundër Republikës Çeke, datë 15.12.2016; Skondrianos kundër Greqisë, 18.12.2003; Clinique des Acacias e të tjerë kundër Francës, datë 13.10.2005; etj.

⁵ Shih paragrafin 2 më sipër.

⁶ Protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 10.10.2019.

⁷ Shkresa e KLGj-së nr. {***} prot., datë 4.12.2019, protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 05.12.2019.



subjektin e rivlerësimit dhe nuk e ka thirrur atë në një seancë dëgjimore publike, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, por e ka mbyllur procedurën administrative pa zhvilluar një seancë dëgjimore në shkelje të këtij parashikimi të posaçëm, si edhe të rregullave të normuara nga neni 89 i Kodit të Procedurave Administrative .

11.5 Kolegji vëren ndërkohë se, lidhur me këtë çështje, ekziston një jurisprudencë e konsoliduar⁸, sipas së cilës mosgarantimi i së drejtës së subjektit të rivlerësimit për t'u dëgjuar edhe në rastet kur Komisioni parashih ndërprerjen e procesit të rivlerësimit si vendimmarrje të mundshme, do të konsiderohet si një shkelje e rëndë procedurale, e cila ka cenuar drejtpërdrejt të drejtën e subjektit të rivlerësimit të garantuar nga neni 179/b, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për t'u zhvilluar ndaj tij një proces i rregullt ligjor.

11.6 Duke arsyetuar si më lart, trupi gjykues i Kolegjit i mbledhur në dhomë këshillimi, pasi mori në shqyrtim këto pretendime të subjektit të rivlerësimit, arriti në konkluzionin se procesi i zhvilluar ndaj tij në Komision ishte kryer në shkelje të rënda procedurale dhe, për pasojë, në zbatim të juridiksionit korrigjues të Kolegjit, sipas parashikimit të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe për shkak të konstatimit të rrethanave që parashikon neni 51, pika 1, germa "b" e ligjit nr. 49/2012, vendosi të kalojë shqyrtimin e kësaj çështjeje në seancë gjyqësore publike, për t'i dhënë mundësi subjektit të rivlerësimit të dëgjohet e të mbrohet për të gjitha pretendimet e parashtruara prej tij në ankim e të padëgjua nga Komisioni.

11.7 Pavarësisht faktit se subjekti, megjithëse mori dijeni rregullisht, nuk u paraqit në seancën gjyqësore të caktuar për t'u zhvilluar për këtë qëllim në datën 28.12.2020, Kolegji e vlerëson këtë veprim procedural si të mjaftueshëm për të shëruar shkeljet procedurale të konstatuara e për të garantuar të drejtat e subjektit për një proces të rregullt, pikërisht ato të drejta të cilat në ankim janë pretenduar se janë shkelur nga Komisioni.

11.8 Në rrethanat e mësipërme të faktit, pas zhvillimit të seancës gjyqësore publike në mungesë të paarsyetuar/shpjeguar të subjektit të rivlerësimit, Kolegji mori në shqyrtim pretendimet e tij të paraqitura në ankim e që adresohen drejt themelit të kësaj çështjeje, që lidhen me kundërshtimin e aplikimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës në pikën e dytë të vendimit të Komisionit.

12. Kolegji mori në shqyrtim pretendimin e subjektit se sanksioni i vendosur në pikën 2 të vendimit të Komisionit, e cila deklaroi humbjen e së drejtës së këtij subjekti për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, është marrë në zbatim të gabuar të ligjit material, pasi: (i) vendimit të Komisionit i mungon plotësisht analiza ligjore dhe juridike në drejtim të shkakut ligjor që ka përcaktuar humbjen e statusit të gjyqtarit, duke e konsideruar këtë vendim si të pakuptimtë dhe alogjik për faktin se e penalizon atë pa të drejtë dhe pa marrë në konsideratë arsyet e ligjshme që e kanë çuar drejt dorëheqjes; dhe se (ii) në këtë proces duhet vlerësuar sa proporcionale është kjo masë me qëllimin e kërkuar dhe se çfarë kërkon të arrijë Komisioni me këtë sanksion.

12.1 Në lidhje me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, Kolegji konstaton se ai është përpjekur në ankim të arsyetojë mosbazueshmërinë në ligj të pikës së dytë të vendimit të Komisionit, pasi prej tij nuk ka pasur në konsideratë arsyet që kanë shtyrë subjektin të dorëhiqet nga detyra, të cilat lidhen me gjendjen e tij shëndetësore dhe që e kanë bërë të pamundur që ai të vazhdojë të ushtrojë funksionin e gjyqtarit.

⁸ Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 1/2018 (JR), nr. 18/2020 (JR), nr. 30/2020 (JR) etj.



12.2 Në mbështetje të këtij qëndrimi, subjekti ka përshkruar në ankim rrethana të gjendjes së tij shëndetësore dhe historikun mjekësor të tij, si edhe ka paraqitur në Kolegj⁹, më datë 16.12.2020, akte që provojnë pretendimin e tij për gjendjen shëndetësore, me kërkimin për t'u marrë si prova në këtë gjykim.

12.3 Në analizë të këtij pretendimi, Kolegji mban në konsideratë parashikimin e pikës 2 të nenit 65 të ligjit nr. 96/2016, e cila përcakton se: *dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar [...]*, në interpretim të së cilës lexohet qëllimi i ligjvënësit për të zhveshur këtë akt që përfaqëson një të drejtë themelore të njeriut (e drejta për të punuar dhe zgjedhur lirisht profesionin) nga detyrime që do të kushtëzonin zbatimin e saj për shkak të vlerësimit të organeve që e marrin atë në shqyrtim. Në interpretim të kësaj dispozite, Kolegji vlerëson se arsyet e dorëheqjes së magjistratëve nga ushtrimi i funksioneve nuk janë domosdoshmërisht pjesë përbërëse e aktit të dorëheqjes dhe, për pasojë, nuk janë pjesë e vlerësimit dhe arsyesimit mbi të cilin këshilli përkatës vendos të miratojë dorëheqjen dhe të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit.

12.4 Në vijim të këtij arsjetimi, Kolegji vlerëson se arsyet/shkaqet që kanë shtyrë subjektin e rivlerësimit drejt paraqitjes së dorëheqjes nuk kanë relevancë për gjykimin e çështjes dhe as për të kontrolluar vendimmarrjen e Komisionit.


12.5 Sipas përcaktimeve ligjore të cituara, në vëmendjen dhe vlerësimin e Komisionit, por edhe të Kolegjit, duhet të jetë vetëm fakti i mbarimit të statusit dhe arsyeja përse ky status ka mbaruar në raport me parashikimin e rasteve sipas nenit 64 të ligjit nr. 96/2016, dhe jo shkaqet apo motivet personale që kanë përcaktuar vullnetin e subjektit për t'u dorëhequr. Për këto arsye, Kolegji, edhe duke prezumuar si të vërteta të gjitha problemet me shëndetin të prezantuara prej subjektit në ankim, si edhe në aktet që ai ka paraqitur bashkë me parashtrimet para seancës gjyqësore, si arsyet që e kanë detyruar atë të dorëhiqet nga ushtrimi i funksioneve të gjyqtarit, vlerëson se ato janë irelevante për të përcaktuar impaktin që ka në procesin e rivlerësimit dorëheqja nga detyra sipas nenit 65 të ligjit nr. 96/2016, që passjell mbarimin e statusit të magjistratit sipas parashikimit të nenit 64, germa "a" e këtij ligji, meqenëse vetë ligji nuk i ka paraparë këto arsye si elemente që impaktojnë as vetë vendimin për miratimin e dorëheqjes.

12.6 Në fund të këtij arsjetimi, Kolegji vëren gjithashtu se ligji nr. 96/2016, në nenin 67 të tij, ka parashikuar për magjistratët mundësinë e pezullimit të ushtrimit të detyrës për arsye shëndetësore, duke ruajtur statusin e magjistratit, parashikim i cili do të ofronte një mundësi për subjektin në rast se ai synonte të mos e humbiste këtë status dhe të mos kishte si konsekuencë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit bashkë me aplikimin e penalitetit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

12.7 Në këto kushte, pretendimi i subjektit për shkelje të ligjit material nga Komisioni, kur ka ndërprerë procesin e rivlerësimit, duke vendosur edhe aplikimin e nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, pa konsideruar arsyet shëndetësore që kanë detyruar subjektin të dorëhiqet, konsiderohet nga Kolegji si i pambështetur në ligj.

13. Në lidhje me pretendimin e subjektit se vendimi i Komisionit në pjesën që vendos penalitetin për humbjen e së drejtës për të qenë gjyqtar ose prokuror i çfarëdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor apo i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokuror i

⁹ Aktet e protokolluara pranë Kolegjit me nr. {***}, datë 16.12.2020, janë përkatësisht ekzaminime shëndetësore, eko kardiake, raport për paafësi të përkohshme në punë i datës 07.10.2019, prova laboratorike diagnostifikim dhe rekomandim i mjekëve të Spitalit Universitar "{***}" Tiranë, si dhe 3 raporte të tjera për paafësi në punë, datë 16.10.2019, datë 21.10.2019 dhe 23.10.2019.



Përgjithshëm ose Inspektor i Lartë i Drejtësisë, është joproporcional dhe nuk realizon qëllimin e ligjit, Kolegji arriti në konkluzionin se është i pambështetur në ligj.

13.1 Në zbatim të parashikimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji çmon se vendosja e penaltetit që parashikon kjo dispozitë në rastet e ndërprerjes së procesit të rivlerësimit për shkak se subjekti dorëhiqet nga detyra, është një pasojë ligjore e detyrueshme për t'u zbatuar në mënyrë integrale.

13.2 Në rastet kur statusi i magjistratit mbaron sepse subjekti i rivlerësimit dorëhiqet nga detyra, sipas parashikimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës dhe interpretimit pajtues të vendimit nr. 78/2017 të Gjykatës Kushtetuese, në paragrafin 43¹⁰, procesi i tij i rivlerësimit duhet të ndërpritet dhe njëkohësisht krijohet edhe pasoja ligjore e ndalimit të qenies pjesë në sistemin e drejtësisë për 15 vjet, sipas parashikimit kushtetues. Kolegji vlerëson se organet e rivlerësimit nuk kanë diskrecion në zbatimin e kësaj dispozite, as për aplikimin në meritën e saj dhe as në përcaktimin e ndonjë afati tjetër të ndryshëm nga ai prej 15 vitesh i parashikuar në të.

13.3 Në këto rrethana, përderisa është vërtetuar dorëheqja e subjektit nga detyra dhe mbarimi i statusit të magjistratit për të për këtë shkak, vendimi i Komisionit që e ka ndërprerë procesin e rivlerësimit dhe ka vendosur të deklarojë edhe pasojën ligjore të parashikuar nga neni G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, është i drejtë dhe i bazuar në ligj, si edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit¹¹.

14. Përfundimisht, Kolegji çmoi se subjekti i rivlerësimit, në momentin që ka vendosur me vullnetin e tij të lirë të ndërpresë detyrën funksionale që e bën atë subjekt të rivlerësimit *ex officio*, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, duhet të merrte parasysh pasojat juridike që do të sillte dorëheqja nga detyra, pavarësisht nga arsyet e paraqitjes së saj, referuar parashikimeve të nenit G të Aneksit të Kushtetutës jo vetëm në drejtim të ecurisë së procesit të rivlerësimit, por edhe në vijimësinë e karrierës së tij në sistemin e drejtësisë.
15. Për sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se zbatimi i pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës dhe se vendosja e masës ndaluese të emërimit në sistemin e drejtësisë për 15 vjet është joproporcionale, Kolegji arriti në përfundimin se vlerësimi nëse ky ndalim është proporcional apo jo nuk mund të jetë objekt i këtij gjykimi, për sa kohë që ai është vendosur nga legjislatori në nivel kushtetues.
16. Në përfundim të shqyrtimit të ankimit të subjektit të rivlerësimit, pasi shëroi nëpërmjet thirrjes së një seance gjyqësore publike e dhënies mundësi subjektit të dëgjohej e mbrohej për pretendimet e tij, Kolegji çmon se shkeljet procedurale të parashtruara në ankim se janë kryer nga Komisioni, janë ndrequr nga juridiksioni kontrollues e rishikues i Kolegjit dhe procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Astrit Haxhialushi kënaq tashmë, në këtë kuptim, kërkesat e nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si edhe ato të nenit 6 të KEDNj-së, të zbërthyera në standardet e vendosura nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cituar nga subjekti në ankimin e tij, për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.

¹⁰ Në vendimin nr. 78, datë 12.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese, në paragrafin 43, arsyetohet se:

"[...] Edhe për sa i takon nenit 56, pika 1 e këtij ligji, kjo dispozitë është vlerësuar si kushtetuese për sa kohë që nuk i mohon subjektit të rivlerësimit të drejtën për t'u dorëhequr, e drejtë që i garantohet atij nga neni G i Aneksit të Kushtetutës. Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe, në këtë rast, procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës".

¹¹ Shih poshtëshënimin nr. 8 më sipër.

17. Për rrjedhojë, bazuar në sa më sipër, Kolegji vlerësoi se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 225, datë 07.01.2020, për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Astrit Haxhialushi dhe zbatimin e pasojës juridike të parashikuar nga pika 2 e nenit G të Aneksit të Kushtetutës, përcaktuar në pikën 2 të dispozitivit të vendimit objekt shqyrtimi, është marrë në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe ligjore dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 225, datë 07.01.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Astrit Haxhialushi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 28.12.2020

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

